



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranor - Prirëno Mëdona	17-03-2023		
Nr. i organit	Numri i caktuar	Shtetësi	Vlera
01-060	01-228	Prilog	Vrednues

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të Nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e -III- të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **23.03.2023 (e Enjte)**, në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektin e vjetër të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve), në Komunën e Vitisë me fshatra.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuara në fsh. Bincë
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit nr.01-013/372, të datës 04.04.2017, për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak me nr. 01-110/05-657 të datës 30.06.2022 për dhënjen në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit nr.01-110/05-395, të datës 08.04.2022, për formimin e Komitetit për Shërbime Publike

Viti, më 17.03.2023

Me respekt!
Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E DYTË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **15.02.2023 (e Mërkurë)**, në Zyrën e Kryesuesit të Kuvendit Komunal, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Liridona Bislimi, ndërsa munguan, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 4 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Përshëndetje për nënkryetarin e komunës, të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, përfaqësuesi i OSBE-së, mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Sot kuorum kemi, po e shofë që po mungojnë në komitet 3 vetë, por megjithatë 4 jemi, shumica është, mund të vazhdojnë punimet e komitetit. Para se me hy në rendë të dites hapim diskutim.

z.Illir Zuka: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë veç deshta me u lidhë me një shqetësim këto ditët e fundit. E kam parë që Plus Televizioni ka pas një mosmarrëveshje me subjektin politikë Vetvendosje, e kanë marrë shumë ngat zemres këtë punën e autostradës, kam pas ndermend me ja bërë një kërkesë që me mu përgjigj në Kuvend shefi grupit Vetvendosjes, pasi që sot nuk ka marrë pjesë në mbledhje të KPF-së, besoj që Liridona ja përcjellë. Me pyet deputetin a e ka të njëjtin shqetësim qysh e ka për autostradën edhe për shkollën e Pozheranit, edhe pse jam i subjektit tjetër, unë kam pranë, i kam pritë në takim në Pozheran edhe u pat zotë që kemi me bë të pamundur ne si deputet në Parlamentin e Kosovës, për me qu këtë proces përpara. Unë e di që ai proces për shkollën e Pozheranit ende është në pikën zero, Faleminderit!

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! E kemi parë të gjithë së fundmi, ta themi që e kemi pas ta themi një largim të një drejtoreshe dhe një ardhje të re. Ky trend ka qenë diçka që kam parë që na ka përcjellë edhe gjatë mandatit të kaluar edhe po shihet që është tu ndodhë gjatë këtij mandati. Unë kisha pas një propozim që, në momentin kur të vie një person i ri me një pozitë që është kaq e rëndësishme, një drejtorie kaq të rëndësishme, por edhe tjerave, momentin kur kryetari ta bënë njoftimin për ardhjen e këtij personi, është mirë që në atë fotografi të vendoset edhe një biografi e atij personit ose tashti ta zëmë në seancën e re, në momentin kur është seanca e parë e asaj drejtoreshe, por edhe tjerëve, nëse kemi rastë të ngjashme ne të paraqitet me një biografi. Ta dimë se çfarë personi, çfarë kuadre kemi të vendosur ose kemi të bëjmë, punë, sidomos ne këshilltarët komunal. Nëse më lejoni të përgjigjem shkurt, pasi që pyetje paraprake ke për subjektin tim, meqenëse jam përfaqësuese e vetmja e subjektit Lëvizje Vetëvendosje, po besoj nëse ke mundur me vërejt Ilir, brenda për brenda shkrimit, se janë bërë disa shkrime, edhe realisht nuk kam mujtë me qenë shumë e kyqyr në këto debate që janë bërë për shkak se kam qenë në trajnim në Shqipëri, por e di që mes rreshtave disa here është përmend shkolla e Pozheranit, brenda për brenda postimeve që janë bërë, po flas subjektit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe deputetit dhe meqenëse është përmendë po dihet që i kushtohet rëndësi po besoj që ka edhe objekte të tjera, punime të tjera po aq të rëndësishme në Komunën e Vitisë, që kishim mujt me i vendos në rast

që e kemi përmend shkollën e Pozheranit. Ne i dimë takimet që i kemi mbajtur, por besoj që i dinë edhe takimet që i kanë mbajtur deputetet e Lëvizjes Vetëvendosje, edhe ke qenë në njoftim për të gjitha takimet që i kanë mbajtur. Faleminderit!

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Megjithatë për shkak të disa rrethanave familjare, pak i shkyqur nga këto, por megjithatë prej takimit të Kuvendit, jo të fundit, se nuk kam marrë pjesë, por prej KPF-së të fundit e deri më sot e bëjë një njoftim që e kam marrë përsiper, i kam thanë Ilirit kujtoja në Kuvend edhe në KPF, tashti kam mujtë me harru. Çështja e shkollës së Pozheranit duhet të ndjekur mbi institucionale, kur kam thënë mbiinstitucionale, githëhere kam mëndu nga qeveria, konkretisht nga kryetari. Prej asaj dite të ndëruar këshilltarë, binduni se i kam bërë 50 thirje. Për qudi Liridona, nuk e kam njetë me të akuzu ty, por e kam njetë me të thirrë me më ndihmu dhe ende nuk më kanë caktu takim që kam kërku takim tek sekretarja permanente e ministrisë. E dinë, mundesh me konfirmu edhe numrin të cilin e kam këtu të sekretarisë, kam qenë shumë i interesum me shku në takim së bashku me drejtoreshën e arsimit, dhe kam pas me marrë ish kryesuesin e Kuvendit, për shkak të rrjedhjes së kontivitetit që ka qenë vazhdimisht në takimet tona, dhe unë me bisedu çështjen ku është kjo pengesë që me të vërtetë është bërë si mollë sherri në Komunën e Vitisë, por edhe në nivel të Kosovës, ata të cilët dinë me qmu, për qudi ndoshta edhe angazhimet, nuk dua të hy në gjynah, se ende takimin nuk e kam zhvillu, por nuk kam mujt me siguru, më kanë thënë është e zantë, tashti për këtë javë më ka lajmru asistentja e saj, se është në pushim vjetorë, që pushimin vjetor, askush nuk mund të ja cenon, është e arsyeshme dhe dje serisht e kam thirrë, që në javën e ardhshme ta siguroj takimin dhe ti shofë mundësitë cilat janë për me shty këtë proces përpara. Tjetra që kisha me ju njoftu, dorëheqja e një drejtoreshe nga arsimi dhe vendosja e një drejtoreshe tjetër, besoj që publike është CV-ja, se kam qenë në takim kur e kemi emru të dytën dhe është kërku një CV që me qenë publike, CV është e publikume, por ndoshta për shkak të trajnimit që ke pas në Shqipëri, nuk ke mujtë me përcjellë. Kjo flet edhe për kualifikimet, ndërsa e drejtë ekskluzive ajo është e kryetarit të komunës. Këtë e dinë, nuk duhet me bisedu, megjithatë ajo çka më shtini kryesues, po e vazhdoj duke ju kërku të falje gjithë këshilltarëve, prej kyresusit, këtë rastë ndoshta është një prej mbledhjeve të KPF-së më jo e përgatitur si duhet, jo për fajin e kryesuesit, as juve këshilltarëve, por ndoshta është për shkak të mungesës time të cilën kam mungu për 1 javë dhe disa pika të rendit të dites të cilat kanë qenë të planifikume. Për sot na u kanë grumbullu që sot nuk i keni rend të ditës, që kisha kërku mirëkuptimin e juaj që ato t'i kemi në kuvend. Në mesin e pikave janë 2, i ka Ajeti. I është te unë, të cilët është kërku vazhdimisht Fatlumi, është në rrjedhë për një ndërhyrje në atë vendimin, planin komunal për energji dhe klimë, të cilët këta i kanë dërgu letra pandërpre, por megjithatë ju ka preferu para dy dite Fatlumi, të veprohet në këtë formë në rastë se na shpallin të ligjshme. E dyta është se, në Kshillin Komunal për Siguri në Bashkësi e kemi sipas udhëzimi administrativ nga pozita zyrtare, duhet të merr drejtoresha e arsimit dhe tashti kemi të bëjmë me një drejtoreshë të re dhe duhet të bëhet zëvendësimi aspektin procedural, se udhëzimi e thotë. Dhe e treta të cilët ne kemi bërë një punë kolesale në krye me Ibadetin dhe disa akterë të cilët punojnë në Komunën e Vitisë, që mos t'i numroj shërbim civil tu e faleminderu edhe OSBE-në që na ka dhënë një ndihmë me asistentë profesional, është fjala për planin e integritetit, i cili është në protokol tashti dhe kisha kërku prej juve mirëkuptimin që të hy në kuvend. Këto janë pikat e rendit të ditës, krejtë këto nëse doni me fajsu dikënd fajsonem mu, nuk është problem. Ju e dini që këtyre çështjeve ju rri kogjo gati, por megjithatë kësaj radhe ka qenë një shkëputje 1 javore, prandaj janë grumbullu deri këtu dhe në rast se hasim në mirëkuptimin e juaj, ish kanë mirë me i shti për kuvendë në rast se jo i lamë në seancat e ardhshme, por megjithatë është mirë me i futë në këtë seancë të kuvendit.

z.Ilir Zuka: Deshta me u lidhë me Liridonën. Nuk kërkoja përgjigje prej Liridonës, se e di që përgjegjësia dhe dëshira e saj janë. Unë veç si pyetje, domethanë grupit të deputeteve të Vetëvendosjes që janë atje. Është marre ti Liridon me thanë është përmend shkolla e Pozheranit, brenda rreshtave e permende këtu, për fatë të mirë nuk ka kamera se e keni politizu shkollën e Pozheranit. Atë ditë ke tu ardhë deri te incidenti nëpërpjet shkollës së Pozheranit, mos e përmend se është marre për ty që ke ardhë ke marrë vota në Pozheran, është përmend shkolla e Pozheranit brenda rreshtave, aq për juve ka rëndësi shkolla e Pozheranit që me u përmend brenda rreshtave edhe zhurmën e madhe që e keni bërë për kyqjen e autostradës që e keni kërku edhe Plus

televizionin, e keni qitë në një mënyrë, është lloj kërcënimi ndaj mediave edhe ti thu e kemi permendë për shkollën e Pozheranit me një rreshtë dikund ka funi. Në seancën e fundit, Pozheranit u qu e ka fy kryesues e kryetarë asamblisti i Vetëvendosjes, e ka fy, i ka thënë po të vjen era kanalizim dhe i tha fajet për shkollë i ki ti.

znj.Liridona Bislimi: Unë nuk e di për ty se si po e cilësojshe vlerësimin, ajo është çështje e jotja. Unë vetëm po dua të them që, në faqen e Lëvizjes Vetëvendosje brenda një shkrimi prej deputetit, prej komplet subjektit, në mesin e rreshtave përmendet kjo që është me prioritet. Ti po thua si paske kushtu. Më fal, por nuk jam tu mujtë me ta kuptu qasjen.

z.Ramadan Deliu: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! E kam fjalën për kuvend. Më së pari ti si kryesues je kanë edhe kandidat për kryetar komune, e renin nuk je tu e mbajtë hiq. U qojishe atë ditë u denoncojshi se çka ndodhi jashtë, e asnjë nuk folke çka ndodhi brenda. Ju PDK dhe VV kare na keni bënë atë ditë në kuvend, kam folë me TV Plusin, duhet me ja caktu minutën me folë edhe replika më nuk e lëshon ingjizimin. Pse po e mbajmë televizorin, nuk është mirë televizori me ti qitë kanalet çka folëm ka 30 herë më kuvend. Unë të kisha qenë në vend tëndin e drejtoj këtë punë. Ti the nuk kam çka i bëjë. Ki çka i bënë, e dhezë mikrofonin dhe i thua, kaq e ki kohën. Edhe televizorit i thua kur të i kryen 3 minuta ndalja zanin, nuk ka nevojë me trasmetu.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ramadan, më së pari kare nuk të ka bënë askush, sepse ka diskutu për temat që i ka pas të rëndësishme. E dya, unë kurr s'ka me insistu me ja lexu fjalinë se çka po folë, se nuk është punë e imja. E merr fjalën dhe folë. Dhe e treta, kryetari ka lypë debat me secilin. Nuk ka pritë me i marrë pyetjet, por tha, unë po du me secilin me u marrë dhe ka kalu forma e debatit në formë tjetër. Mos prit që mundem unë me u qu dikëndë me kap për fyti me ja ndalë fjalën, mirëpo asnjëri i PDK-së nuk e ka cenu askënd. Çka do që diskutohet aty, ata, njerëzit jashtë kuvendit nuk mundet me ardhë me sulmu për fjalë dikënd aty.

z.Ramadan Deliu: Nuk ka hy brenda askush.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te dera e ka pritë, ajo nuk është e falshme, se ajo kalon te çështjet tjera. Brenda Kuvendit ndonjëhere mundemi me pas eskalime, mundemi me pas ndoshta edhe tejkalime si i kemi pas, që nuk është mirë. Fjala e Durimit ka qenë absolut për me u denu, aty kur thotë kanalizimi nuk funksion në Verban, që i vjen era e qeverisjes suaj, që i rrokë edhe drejtorat, kryetarin, që e rrokë krejt ekzekutivin. Kjo domethanë ana njerëzore nuk e lejon me thanë këtë. Asnjëra nuk arsyetohet se çka ka ndodhë aty.

z.Illir Zuka: Merrne shikone procesverbalin, jam prej atyre që e kam dënu rastin. Kjo ka ndodh prej jashtit sulmi brenda, por edhe ju si subjekt i Vetëvendosjes duhet me denu gjuhën fyese të asambleistit ndaj qeverisë, nuk është marre Liridonë. Është marre me i thanë kanalizim qeverisë, është shprehje më e ultë e mundur.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Degjoni të gjithë, përkundër dhimbjes që kam pas kam mujtë mas 12 t'natës me pa dhe më ka ardhë shumë keq. Unë sillem në politikë prej viteve 89-të, jam anëtarësu me një parti në jetën time. Ti e dinë edhe garën, edhe kur kam bisedu, kur nuk jam pajtu, edhe me të juajit kur nuk jam pajtu, edhe me shefin e grupit të tyre, kesi fjalori nuk bënë. E dini edhe para këtij komiteti, Iliri mu idhnu pak kur i thashë, Ilir, duhet krijojmë kulturë, se unë i kam parë rrethanat të cilat vazhdimisht tu ardh, tu nxitë, që vjenë një ditë, nuk është me rëndësi a ja ka bënë Hasanit apo Liridones është e njëjta për mua në rast se perdoret një fjalor i cili nuk i përket shekullit 21, ku jemi ne nuk dua me marrë model Kuvendin e Republikës së Kosovës model, unë i marr kombet e mira që më konvenojnë fjalori fyes shumë here e kam përdor se kam edhe një traditë të pajtimit të gjaqeve ne më të kulturum po dalum prind e tanë që janë kanë analafabetë në aspekt shkrim lexim se nuk e ka fy kurr askend, por edhe nuk e ka leju me fy se po dalem ne këtë pyetje, duhet me shtu pa e arsyetu atë sulmuesin që veç çka e kam ndegju unë sefte fjalorin po e denojë e mandej nuk diskutohet për sulmin fizik. Unë pajtohem me kryesuesin kur thotë, unë nuk ja lexoj, se ne nuk kemi censur secili e ka atë autonominë e vetë, por ju si subjekt politik dhe ne si subjekt politik mundemi me i thanë këshilltarit tanë atë fjalor fyes ndërpreje në kuvend. Kush je ti që e prish klimën politike në Viti. Kritikë për mos punë ne ti bënë 6 ditë pa ndërpre, por me i thanë një njeri 50 vjeçar, ka drejtorat edhe më të vjetër, me i thanë po të vjenë era kanalizim, se edhe mua më ka thanë tu nejtë në Remnikë, ky nuk është fjalor. Duhet ketë me kuptu edhe këtë nuk po them me marr me qu në burg, por me i thanë ulu njëhere në tokë të bukës, nuk je midisi dynjas që je zgjedh këshilltar i kuvendit komunal, kanë me u zgjedhë shumë pas teje, janë zgjedhë edhe para teje, por fjalori yt nuk e ke bërë, mirëpo të rrjedh kanalizimi bonë me të qu në prokurori, krejt janë të pranushme, por fjalor që e lëndon individin dhe ja

lëndon familjen duhet me pas kujdes. I jetra, është hala më e denushme ai tu prit a është kanë e organizume, a ka qenë rasisht, nuk dua ta konkludoj, për me ardhë në atë duhet me pas një vendim të gjykatës që ka konstatu dhe krejtë këto janë të papranushme. Kush mundet me i rregullu këto, ne mundemi, ti me këshillu atë tëndin, unë temin, Beka të vetin edhe me hecë qysh duhet. Zgjedhjet janë 1 muaj fushatë, tash po i shkurtuam 15 ditë, 10 ditë, dalim me program, nuk fiton programi i cili shanë, fiton programi i cili i ofron qytetarit ***, dhe ai që fiton duhet me ja bë përhapër dhe me hecë. Komuna e Vitisë nuk është vetëm e pozitës, por është edhe e pozitës edhe opozitës, edhe buxheti është ashtu edhe investimet janë ashtu. Ligji ka thënë se, duhet me i implementu ai që ka fitu edhe u kry muhabeti.

z.Ramadan Deliu: Unë e pata edhe një pyetje për nënkryetarin. Dashta me të vetë, e kemi votu tokën me interes të veçantë në Letnicë, për ujë, ku kemi mbërri a e kemi gjetë atë njërin.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Nuk po mundemi me gjetë, te dy priftave ja u kam dhanë, nuk është ai këtu është në Kroaci. Të dytë janë zotu që do ta gjejnë, por ende nuk ka informatë prej tij.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit për të gjithë! Për këtë seancë materialin e keni marrë me kohë, kemi parapa këto pika të rendit të ditës.

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023.
4. Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2023 dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm të Komunës së Vitisë, për periudhën kohore 2023-2025.
5. Informatë për planifikimin përfundimtar për prokurimin për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Te rendi i ditës patëm edhe pjesët që i diskutoj edhe nënkryetari, propozim për ndryshimin e Vendimit për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë 2022-2030 me Nr.01-110/05-1346, i datës 05.12.2022. Ky vendim deri tani nuk na është kthyer i ligjshëm, na ka kthyer që duhet të plotësohet. Kanë lyp dokumenta shtesë dhe në bazë të pjesës së fundit që edhe Fatlumi ka diskutu, këtu kërkohet ku është energji dhe klimë me u heq vetëm fjala klimë me mbetë vetëm energji vetëm për këtë na e kanë kthyer në rishqyrtim nuk ka asnjë ndryshim tjetër, vetëm fjala klimë. A jeni që edhe kjo pikë të hy në rend të ditës. Nga të gjithë të pranishmit miratohet që edhe kjo pikë të hy në rend të ditës.

Pika tjetër e rendit të ditës:

Propozim vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022 të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

z.Illir Zuka: Për shkak që nuk e kemi materialin, pse nuk po i shtimë me një bllokë. Këto pikat shtesë edhe mos me i diskutu këtu përshkak se, ne nuk e kemi materialin ti vetëm i lexon dhe ne me qu dorën.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Shembull. Tek disa pika këtu, material nuk na vynë se është vetëm ndryshimi i Fatbardhes me Arten. Si pikë e 3-të që kërkohet

Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026

Parimisht kjo me material qenka i gatshëm për këtë plan. Nëse nuk është urgjent na kish vutë edhe për seanca të tjera, pasi është planë më i gjanë. Me ngritje të dorës: a jeni që kjo pikë të hy në rend të ditës? Nga të gjithë të pranishmit u miratua edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Pika tjetër e rendit të ditës:

Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Gërmovë

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtë e kemi miratu edhe në buxhet 160 mijë euro është ndërtimi i objektit për personat me aftësi të kufizuar. Tashti caktimi i lokacionit në fshatin Gërmovë e paskan parapara. A jeni që edhe kjo pikë të hy në rend të ditës. Nga të gjithë u miratua edhe kjo pikë që të hy në rend të ditës.

Pika tjetër e rendit të ditës:

Propozim vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës përmes ankandit publik

z.Ajet Sallahu, drejtori: Kjo tashti është për afatgjatë. Domethanë është fjala për mbjelljen e arrave, lajthiave dhe shpeztarisë. Dy bunara për ujitjen e tyre njësi solare për energji për ato kultura, pas investimit 15 vite në lajthi dhe në arra nuk ka mundësi për me mujtë me nxerr profitin që e merrë në shfrytëzim, nëse e merr, se kjo vendoset në ankand publik, prandaj është shku në afatgjatë. Kjo në afat të shkurt nuk i konvenon askujt dhe askush nuk ka apliku.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ne këtë vendim e kemi në procedurë. Ne e kemi edhe komisionin e forumit prej kuvendit, e kemi edhe komisionin për procedura. Domethanë këto janë vetëm procedura. Këtë e kemi kalu në Kuvend vitin e kalim, e kemi komisionin e forumit, kjo është në procedurë edhe kjo, por edhe në Smirë diku janë 18 ari. Janë dy vendime që janë të kalime kjo edhe e Smirës që priten vetëm në procedurë.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Për afatgjatë më duket që e ndanë ministria.

z.Fatlum Demiri, sekretari kuvendit: Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës. Dhënia e pronës së paluajtshme të komunës me afatgjatë duhet të bazohet në kriteret si vijim: prona e paluajtshme duhet të jetë e regjistruar dhe të publikohet në web faqe. Prona e paluajtshme e komunës, e cila jep në shfrytëzim afatgjatë të jetë e harmonizime me planin zhvillimor komunal. Të ketë arsyeshmërinë e interesit publik, propozimi nuk ka arsyeshmeri këto që po i shofë, se normal është dashtë në propozim me shkrujt një arsyeshmeri, pse po i merrë, çka kanë me u shfrytëzu, t'i i plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara mjedisore. Nuk e di a janë plotësu kriteret. Këto janë kriteret që i kërkon Ligji për Dhënien e Pronës në Shfrytëzim. Dhënia e pronës në shfrytëzim afatgjatë bëhet përmes konkursit të hapur publik dhe kriteret e përcaktuara me këtë ligj.

z.Ajet Sallahu, drejtori: Fatlum, nuk ka nevojë ligjet me i diskutu, se kot diskuton. Është në pyetje kjo, se unë nuk e kam ditë që ka kalu në kuvend. A duhet mu anulë ai vendim. Kjo është pyetje se, kjo nuk është në pyetje se ato procedurat nuk mundet askushë me i tejkalu, ato janë të parapamë me ligj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Drejtor, këtë e kemi të kalime ne si vendim, ne e kemi për 15 vite të miratime kemi dhe komisionin, veç ka pasë me hecë procedurat pse nuk i kanë fillu procedurat, ajo është çështje tjetër, ai është komplet i bëmë gati vendimi. Unë mendoj që ne duhet me shty këtë vendim, nuk e kishim shti në këtë seancë, shikoje me atë që është procedura me komision a mundet me vazhdu ajo. Nëse nuk mundet, atëherë anulojmë për seancën e ardhshme.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Unanimitetin apo fuqinë komisionin e ka marrë nga ana e kuvendit për afat shkurtë dhe prandaj nuk mundet i njëjti komision me vendos afatgjatë, prandaj duhet me shku me anulë atë. Për me ardhë me e kompletuar përveç një neni drejtor që e kufizon ti, thu sikur ati që ja kemi hupë të drejtën në Letnicë për herë të parë ne e kemi bërë brenda 1 viti me fillu 3 vite me përfundu, ja cakton një arsyeshmëri që po të thotë edhe ligji elaboratin e ti se, cili do të jetë interesi i përgjithshëm mjedisor jetësor i njerëzve që do të jetë 10 hektarë me bë një përshkrim, mos me shti në vendim, por ja bashkangjetë këtë që këshilltarët me pa se çka ka me u bë edhe dalim të kompletuar.

z.Illir Zuka: Në fillim me bë propozim vendim për shfuqimzimin e vendimit.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë kisha kërku që këtë pikë mos me shti në rend të ditës për seancën e ardhshme. Me i bë ato shtesë edhe me bë atë vendimin për shfuqizim, plus komisionin e shtin me një seancë. Edhe me shti sot ne duhet me bë edhe një vendim tjetër për komision, e kështu me një seancë i krymi krejt.

z.Ajet Sallahu, drejtor: Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi nuk është kompetent me i caktu afatet se sa është kuvendi që i cakton afatet, mund me caktu në bazë të listës që e ka. A është afatgjatë apo afatshkurtë ne nuk jemi kompetent me caktu, por edhe mundësia e dytë është se në fund krejt asaj nëse të kalon në kuvend edhe kalon në ankand, kryetari është i obligim me bë një kontratë e ajo kontratë e klauzurë që po thuni nënshkruan kontrat kur ta bëjnë kryetari me shfrytëzuesin e shkruar nëse për 1 vit nuk fillon punimet i tërhiqet.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Drejtor, asnjë propozim vendim nuk mundet me të ardhë nga lista të cilat i ka kalu kuvendi, atë listë të cilën e ka kalu kuvendi ka thënë në procedurë afatgjatë, ti hynë në afatgjatë, ka thënë në procedurë afatshkurtë, aty më nuk ki ndryshime, dhe ne duhet me punu konform asaj ka palë që nuk i ineteron thotë qenka afatshkurt, nuk e qetë hiq se procedurat e kuvendit ne nuk mundemi me i ndryshu 100 here, duhet me mësu këtë rregull a atë regjistër ti je obligativ me përcjellë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht ne nga Komitetit për Arsim, Shkencë, Kulturë, Rini dhe Sport e kemi pas një rekomandim që Drejtoria e Arsimit me na e pru një informatë për përfundimin e vitit shkollor dhe fillimin e vitit të ri shkollor nëse na e bjenë një informatë ja qojna një e-mail drejtorisë këtu e keni edhe kërkesën edhe në planë të punës së kuvendit është kjo informatë, ndërsa unë për një pikë që e kam më herët të propozume prej Liridonës një kërkesë ka qenë tashti edhe këto prej Sokol Shaqirit ka qenë, është formim i komisionin për emërtimin dhe riemërtimin rrugëve, rrugicave janë një pjesë e ankesave një pjesë e korrigjimit të emrave se një pjesë edhe emrat janë gabim. Unë mendoj tashti ose e lajmë për seancën e ardhshme, se na u bënë shumë pika tu bazu në vendimin se ne e kemi bërë një vendim në vitin 2019 nuk ka funksionu ai komision sepse nuk ka pasë mundësi për rishqyrtim sepse nuk i kanë bërë 5 vite ato në bazë të rregullores dhe me përfundimin e mandatit kuvendit i përfundon mandati, ne po e lajmë për seancën e radhës se nuk është diqka shumë urgjente për muajin e ardhshëm kemi parapa 3 subjektet e mëdha me i pasë ka një antarë 1 gjeodezë 1 historian 1 gjeografë 1 veteran 1 gjuhtarë sociologë kordinatorë për kshillrat e fshatit dhe prej shoqris civile parimishtë u bazu në vendimin e më hershem që është bërë për seancën e ardhshme koordinohemi.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: E kemi edhe një raportë të shkurtë të auditorët të brendshëm. Unë kam bisedu me auditorin, do ta kalojmë në kuvend për shkak të grandit të performancës dhe planin e veprimit për tejkalimin e atyre brenda vitit*** kjo do të jetë për seancën e ardhshëm sepse u bëjshin shumë pika dhe nuk e prunem në këtë seancë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Vazhdojmë me rendin e ditës.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa

z.Illir Zuka: Fillimisht e diskutova me Fatlumin, për shkak kur na ka ardhë materiali nuk është skanu. Janë fletë, krejtë në rregull jemi për atë. Unë kisha kërku prej teje në një mënyrë me i letu, se këta janë duke bë skripta, nuk janë duke bërë procesverbal, nuk janë duke bërë dallim kryesues edhe ata asambleistë nuk janë tu e kuptu. Tashti po dalë në atë pjesë, sepse kam qenë 9 vite pjesë e kuvendit, si asistent jam mirr direkt me këtë punë, ata nuk janë duke i kuptu se procesverbali edhe skripta kanë dallim në mënyrën se si janë duke e kërku. Përshembull unë isha sot në zyre te skeretaria, te Fatlumi, 35 faqe procesverbal. Ai nuk është procesverbal, ai është libër, skirptë është 35 faqe me të ardhë me matrial, ai është skirptë edhe këtë nuk po e kuptojnë dhe po qohen po bëjnë ankesa shembull në kuvnd, nuk mi ke shkru këto fjalë ma ke shkru këtë fjalë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Unë i kam kërku edhe procesmbajtësit, në mometin që ka fol prej vendit, nuk e ka marrë fjalën, mos e shtin. Nuk është ai në procesverbal, në procesverbal është vetëm ai që ja jap fjalën. Unë në momentin që nuk e marr fjalën, nuk shkruhet në procesverbal, ose te ndërhyrja mundemi me bë llaf çka folëm sot, munden me na dal 30 faqe. A jeni që të miratohet procesverbali? Pra, nga të gjithë të pranishmit miratohet procesverbali.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Një here këtë e kemi pas në kuvend, e kemi qit në diskutim publik. Është një rregullore unike në nivel vendi, propozim prej asociacionit ka shku e njëjta nëpër të gjitha komunat, dhe varsisht me procedurat dhe karakteristikat e vendit kan mujtë ndonjë ndyrshim të vogël.

znj.Liridona Bislimi: Tek materiali mungon, sepse në fund nënkupton se, shfrytëzimi i pronës komunale duhet të shfrytëzoj pronën vetëm sipas destinimit të pronës dhe nuk ka më tutje.

z.Illir Zuka: Edhe nëpër komunat e tjera me material me laptopa e kanë të njëjtin problem. Unë kontaktova me Fatlumin. Përshembull, te procesverbali ti më kishe qitë diçka tjetër, atë që kam bërë debat me nënkryetarin nuk ish hiq, e kqyrem mandej, por materiali nuk ish skanu hiq.

znj.Liridona Bislimi: Është këtu neni 1, qëllimi me këtë propozim rregullore përcakton kriteret, kushtet, procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme, edhe nuk është që kemi pas diçka me bë krahasim ose ndonjë ndryshim sado i vogël me qenë, kështu që ne e kalojmë, por shpresojmë që për kuvend vjen materiali i kompletum.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kush është që kjo pikë të shkojë në kuvend me plotësimet. Pra nga të gjithë të pranishmit të cilët janë pro, edhe kjo pikë që të shkojë në kuvendë.

Si pikë të tretë e rendit të ditës është:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2023

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht në Komitetin për Komunitete vjen një plan përhere. Komiteti e dini që është i formuar prej kuvendit, është obligativ, i mbanë disa takime të rregullta, japin disa rekomandime.

znj.Liridona Bislimi: Mendoj që kishte me qenë e arsyeshme me qenë një përfaqësues prej këtij Komiteti për Komunitete, edhe pak a shumë me laburu këtë planin e punës. Diskutimin më të madh edhe më të lehtë unë për vete, personalisht po e bëjë këtu. Është një planë i punës, por nuk ka diçka të specifikume. Përshembull sikur planet tjera që i kemi pas me takime, me angazhime, me data. Kjo është në mënyrë shabllone, veç të mbajë takime të rregullta një here në muaj. Ne i kemi pas 1 here muajt kur kemi me mbajtë edhe mbledhjen e seancës së Kuvendit Komunal shembull të përcaktume, e këtë te ky komitet nuk është që mu dokë plani i punës shumë strikt dhe për atë kam pas ndoshta shumë pyetje me i bë që ish kanë më mirë me i bë këtu se në kuvend komunal, tu e marrë parasysht që jemi duke folë për një periudh 1 vjeçare mu përfshi krejtë kaq shkurtë po më duket që është pak i dobët.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Me ngritje të dorës: a jeni që edhe kjo pikë të shkojë në kuvend? Pra, nga të gjithë të pranishmit edhe kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i planit vjetor për vitin 2023 dhe plani strategjik për Njësinë e Auditimi të Brendshëm të Komunës së Vitisë, për periudhën kohore 2023-2025

z.Elmas Zeqiri: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Nuk dua të marr shumë kohë në prezentimin e planit vjetor, planin strategjik të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të Komunës së Vitisë, duke u bazuar në planin e Ligjit të Auditorit të Brendshëm, më vonë në Ligjin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike të bërjes mbi auditimit të brendshëm nëpër të gjitha komunat e Kosoves është i obliguar të bëjë planin strategjik 3 vjeçar te plani vjetor, në planin strategjikë 3 vjeçar që kësaj here i vjen 23, 24, 25, ndërsa plani vjetor është ky viti 2023, plani strategjik dhe plani vjetor bëhet çdo vit deri me 31 dhjetor të vitit fiskal, gjegjësisht kalendarike dhe i përcjellat një kopje kryetarit të komunës, një komitetit të auditimit dhe një Njësisë Qendrore të Auditimit. Ne jemi të obliguar t'i raportojmë vetëm këtyre 3 instancave. Pasi që keni pika shtesë, nuk dua që ta zgjasi, sepse materialin e keni marrë me kohë, për çdo pakjartësi e çdo pyetje rreth planit strategjikë për Njësinë e Auditimit të Brendshëm të Komunës së Vitisë jam në dispozicionin tuaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit z.Elmas Zeqiri! Ne këtë pikën parimisht shpesh e kemi trahtu, nuk je duke dhënë raport por je duke e paraqit planin e punës dhe planin strategjik. Parimisht unë shpeshherë kam lypë, edhe nënkryetari e din, por nuk kan sjellë raportë në kuvend dhe komitet Zyra e Auditimit të Brendshëm vetëm raportin e auditorit të jashtëm. Domethanë pjesa e funksionimit të pushtetit lokal edhe kuvendit komunal bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisje Lokale që i parashef paraqitjen e planit të punës dhe planit strategjik që je tu e paraqitë sot dhe për këtë arsye ne zakonisht kemi insistu për shkak të kërkesës.

z.Elmas Zeqiri: Ky është problemi. Përderisa Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale është i vitit 2008, Ligji i Auditimit të Brendshëm i 2009 është dashtë koordinohet njeri me tjetrin, jo njëri thotë po tjetri thotë jo. Edhe ligji më i ri tani i vitit 2018 i kontrollit të brendshëm të financave publike po ashtu nuk e parasheh vetëm këto 3 seanca që i përmenda më herët, megjithatë ne do t'i prezantojmë. Raporti i punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, ai nuk parashihet këtu as para Komitetit për Politikë dhe Financa, as para kuvendit, me përjashtim të informatës të cilën e jep kryetari për të gjitha drejtoritë komunale.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Unë jam i interesum maksimalisht, java që ka shku ti e dinë që kemi pas takime edhe mospajtime edhe me mua të aspektit profesional mund të gëzojmë pavarisist që s'je i mendimit tim, megjithatë unë kam pyet edhe në ministri edhe në Demos, nuk mundesh ti mi qitë 4 pikë grandit të performancës me mi hup kur ligji nuk po e detyron auditorin me dhanë dhe ma kanë qu në e-mail me shkresë se më lejohet me qitë edhe raportin tëndë në kuvend ma ka qu Demosi.

z.Elmas Zeqiri: Demosi nuk është organ i cili na dikton neve se si të punojmë. Ne e kemi Ligjin e Auditimit të Brendshëm edhe e kemi ministrinë tonë, gjegjësisht Njësia e Auditimit të Brendshëm.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Demosi të vlerëson në përputhje me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal është e formume me ligj që e ka marrë bekimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe nuk guxon me të ngarku me diçka e cila është kundër ligjore dhe ajo zonja që ka pas mirëkuptimin tim i shtin edhe cilat nene t'i lejojnë edhe ta japi unë nxjerrje prej saj edhe tashti e tutje ne vazhdojmë. Unë jam i interesum me i zgjedh kuvendarëve krejtë ajo çka është e përcaktume me ligj dhe jam i interesum Komunës së Vitisë grandin e performancës prej 900 mijë me bë 1 milion e 200 mijë, jam i interesum maksimalisht.

z.Illir Zuka: Kisha disa pyetje për drejtorin e auditimit. Atëhere kur nuk na vjen raporti, mos e sjell as planin se, nuk kemi nevojë ne me shqyrtu planin kur nuk kemi raport, se ti mundesh me thanë kemi me i bë këto e këto, por në realitet a e ke bë, si drejtorë me 2 puntorë të shkojnë 2-3 muaj për me bë një auditim, por ti je vetë. Unë po besoj që a ke arritë me përfundu 1 ose asnjë kjo është mendim, se unë nuk kam raport, sepse ti nuk e ke sjellë. Unë po mendoj kryesues që nuk ka pas nevojë as plani me ardhë pa raport.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Ilir, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Zyra e Auditimit aty shkrun që, duhet me pru planin e punës dhe planin strategjik në komitet jo në kuvend, dhe në komitet rregullisht e kanë pru, edhe sot e prunen. Kjo është ajo çka na takon neve me sekretarin dhe e kemi kërku prej këtyre për në komitet. Në kuvend nuk vjenë plani as i prokurimit as i auditimit.

z.Illir Zuka: Kryesuesi e dha përgjigjen çka pata me dhanë unë, por vetëm po e plotësoj. Auditimet e brendshme janë konfidenciale, janë për menaxhmentin, janë jo publike, mos i harroni këto 3 fjalë, prandaj raportet e auditimit të brendshëm prezantohen vetëm para kryetarit të komunës, Komitetit të Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë Qendrore të Auditimit, por edhe plani i ka shku këtyre 3 instancave. Ky plan që po e bisedojmë sot më shumë e ka karakterin informues se sa shqyrtues dhe aprovues, ndërkaq raporti i punës nuk parashihet me Ligj të Auditimit të Brendshëm të prezantohet as para KPF-së, as para KK-së. Ky i prezantohet vetëm atyre 3 instancave që ju thashë. Sa i përket drejtorit të Njesisë së Auditimit, Ligji i Auditimit të Brendshëm thotë, gjegjësisht Ligji mbi Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nëse një komunë e ka një Njësi të Auditimit, ai duhet ta ketë një drejtor i cili e përfaqëson Njësinë e Auditimit edhe nëse nuk e ka asnjë punëtor, megjithëse ne mund t'i kemi 3 auditorë me ligj, kemi qenë 2, tashë jemi 1, a me ligj kemi të drejtë të jemi 3. Kjo caktohet në bazë të vlerës së buxhetit, mbi 1 milion euro buxhet është 1 auditor, mbi 3 duhet t'i keshë 2, ndërsa mbi 5 na takojnë 3. Ne tani kemi 13 milion e gjysmë buxhet, që do të thotë pa problem mundemi t'i kemi 3. Pse nuk i kemi është çështje tjetër.

znj.Liridona Bislimi: Ajo çka e tha nënkryetari, pata veq me bë si hyrje se na e kemi pranë vetes planin vjetor edhe është një far materiali vuliminoz, mirpo pa raportin e këtij plani realisht ne nuk dimë ku me u bazu se çka me nxjerrë ose çfarë diskutimi me bë, kështu që është mirë me pas edhe raportin, mandej me raportë është njëfarë përfshirje e madhe dhe mundemi me ditë ku me u bazu dhe çka me disku. Mua po më intereson me ditë sa anëtar jeni ju si stafë edhe pse deri tashti nuk është plotësu numri i stafit, kur e dimë se vitin e kaluar drejtori ka kalu në pension edhe vetëm pozita e drejtorit është plotësu, por jo edhe pozita tjetër e stafit, ashtu siç e përmendni edhe ju në bazë të ligjit edhe rregullores. Çdo autoritet kontraktues, për çdo komunë të cilat kanë buxhet mbi 7 milion parashihet ti ketë minimumi 3 auditorë të brendshëm. Në këtë rast ne si komunë nuk i kemi, nëse nuk i keni dhe keni mangësi kaq të mëdha, a mundeni me na shpjegu se si mundeni me realizu këtë planin e punës që e keni kaq plan dinamik në mungesë kaq të madhe të stafit punues për vitin 2023. Po më intereson me ditë cilat drejtori i keni parapa për me e bërë auditimin, a i keni nda, a i keni specifiku, a mundeni me na tregu, në vitin e kaluar 2022 keni bërë auditimin e Zyrës së Prokurimit, tatimit në pronë, shpenzimet e mallrave, shpenzimet për komunali edhe subvencioneve, por ne nuk mundemi me ditë se ku i keni dhanë ju vërejtjet në këtë pjesë. Në këtë auditim të vitit të kaluar, siç e përmendem edhe pak më parë për shkak të mungesës së raportit të auditimit, a i keni vendos këto në raport, a mundemi me i pa.

z.Elmas Zeqiri: Unë pak më herët e përmenda që auditimit i brendshëm është konfidencial, përderisa auditimet e jashtme janë publike, që i keni edhe në web-faqe auditimet e brendshme janë konfidenciale. Këto janë vetëm për menaxhmentin në dobi të organizatës buxhetore që të shihet ku janë gabimet, pse janë dhanë këto rekomandime.

znj.Liridona Bislimi: Ju si drejtor i auditimit na intereson me ditë sa aktivitete i keni parapa për vitin 2023. Vitin e kalum e keni parapa edhe menaxhimin e pasurisë, por nuk e keni arritë me përfundu. Pse ka ndodhë kjo dhe a e keni parapa menaxhimin e pasurisë për vitin 2023.

z.Elmas Zeqiri: Ne duke u bazuar në atë se do të kompletohem me stafë edhe vitin e kalum, së paku kemi 2 auditorë, kemi planifiku aq auditime, por meqenëse nuk është plotësu stafi, nuk kemi caktu një auditim. Nga ato të planifikuara që kanë qenë 4, janë kry 3, edhe këtë vitë duke e pa se po zhagitet çështja e kompletimit të stafit, prapë nuk kemi guxu të parashohim shumë obligime për shkak se veç po delë pasqyra jo e mirë që ke planifiku kaq, ke realizu kaq. Kështu që edhe këtë vit i kemi planifiku 4 auditime dhe nëse bëhemi 2 auditorë së paku ne mund të arrijmë ta realizojmë planin, nëse jo prapë mund të mbetet pa u realizu planin. Unë në Shtator nëse e kam shneten heci në pension, kështu që ka pak rrezik Zyra e Njësisë së Auditimit të Brendshëm të mbetet bosh, por ndoshta kompletohet brenda këtij afati 6 mujorë.

znj.Liridona Bislimi: Te numri i madhë i personave me kontrat mbi vepër a keni parapa me bë ndonjë hapë konkretë si e gjetur e auditorit

z.Elmas Zeqiri: sikur të kishim arritë ta menaxhojmë zyrën e personelit por thashë që në munges të stafit nuk po arrihet të i bëjmë të gjitha këto auditime atëhere aty do ti kishim gjetë se sa ka stafë me kontrat mbi vepër, ju këtu i keni informatat nga auditorë i jashtëm edhe mundeni me u bazu edhe në atë që e kemi vetëm 1 anëtar, sepse nuk kemi arritë të bëjmë auditime dhe pa auditime ne nuk dëshirojmë të flasim kështu.

znj.Liridona Bislimi: Mesa e kam kuptu dikun 30 mijë euro janë bartur prej subvencioneve, a i keni bërë auditimin e kësaj pjese se, në cilat kode buxhetore do të barten a keni pas mundësi me u angazhu në këtë pjesë.

z.Elmas Zeqiri: Nga një prej auditimeve që e kemi bërë vitin e kaluar ka qenë edhe auditimi i shpenzimeve komunale të Administratës Komunale për mallra, shërbime, komunale dhe subvencione edhe për subvencione, i kemi parë se cilat janë të gjeturat dhe cilat janë rekomandimet, por nuk kemi dhanë ne rekomandime vetëm për subvencione, kemi dhanë edhe për mallra e për të gjitha.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Liridonë, ju keni hy te pjesa e raportit, ne jemi te pjesa e planit, sepse pjesa e raportit po ardhka në seancën e ardhshme në bazë të drejtorit dhe ato mundemi t'i diskutojmë.

z.Elmas Zeqiri: Edhe raporti i auditimit të vitit të kaluar që po e kërkon zëvendëskryetari ka me u bë në versionin e shkurt vetëm të gjeturat edhe rekomandimet. Atje vjen versionin i shkurt nuk vjen raporti origjinal, vjen vetëm me 2 faqe, atëhere edhe aty tash çka me bë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kur të vjen raporti i gjetjeve, aty bëhet pyetje përgjigje.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Liridonës nuk i intereson se a ka shku vajza e Hasanit në kontratë në vepër. Kjo vetëm pyet a ka pas me kontratë në vepër, ti ki me thanë po, edhe kjo është kështu. Po doni me pshtjellë një çështje që është shumë e pastër, e gjetur, kontrata mbi vepër, plani i veprimit mundet me anu kjo dhe shkojmë më tutje.

znj.Liridona Bislimi: Te faqe numër 17, pika 6.3, ndarja e detyrave të punës së auditorit e keni shënu, kështu Njësia e Auditimit të Brendshëm përbehet prej drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe një auditori të brendshëm.

z.Elmaz Zeqiri: Në planifikim.

znj.Liridona Bislimi: Është në planifikim për të ardhmen për këtë vit. Në fund, krejt këtij aprovimit të planit është hedhur nënshkrimi i kryetarit Sokol Haliti, drejtorit Elmaz Zeqiri, pse po mungon nënshkrimi i kryesuesit të Komitetit të Auditimit.

z.Elmaz Zeqiri: Është aty, por ndoshta kur është skanu nuk ka skanu atë pjesë.

znj.Liridona Bislimi: Në fund është aprovimi i planit strategjik.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit drejtor! Kjo pikë nuk del në votim, nuk ka me shku në kuvend.

Si pikë të pestë të rendit të ditës:

5. Informatë për planifikimin përfundimtar për prokurimin për periudhën janar-dhjetor 2023

z.Fadil Abazi: Përshendetje për të gjithë! Bazuar në komizën ligjore, para jush prezntoj informatën për planifikimin përfundimtar për prokurimin, për periudhën Janar-Dhjetor 2023. Për mos me ju marrë kohë më shumë, materialin e keni marrë me kohë, për pyetjet shitesë jamë në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Kësaj radhe po e shofë që ka më shumë aktivitete që janë parapa, asfaltimi i rrugëve rurale, jo vetëm këto, është edhe kanalizimi, janë disa të ndamë që nuk kanë qenë deri tani.

z.Fadil Abazi: Është më shumë ngarkesë, por më praktike, se ngarkohemi me aktivitete më shumë dhe mundësia me i zhvillu është problem për shkak të kushteve që i kemi, mirëpo këto janë të planifikume. Nëse zhvillohen krejt, ka mundësi të mos zhvillohen, por këto perjashtimisht kapitale, këto tjerat munden mos mu zhvillu fare, varësisht prej kërkesave, mirëpo janë të planifikume se ashtu e lypë ligji. Edhe në gjithçka që mendojmë me bë e bëjmë në planifikim, atë qka arrijmë me bë e bëjmë.

z.Illir Zuka: Pikë së pari: a i keni bërë gati këto për shpallje? Kur e dimë që vitin e kaluar keni pas shumë probleme me ankesa, edhe plani është vonu për shkak që keni pas shumë ankesa në OSHP dhe tu e ditë se sa ka qenë funksionale OSHP-ja, besoj që këtë vit nuk do të ju përsëriten. Unë e kam një pyetje, këtu po e shof trotuar, rruga, etj. Domethanë janë cek për krejtë fshatrat. Unë si asamblist kam të drejtë me i dhanë një këshillë Zyrës së Prokurimit, me ditë saktë ku janë ato, shembull ki trotuare.

z.Fadil Abazi: Këto i ki tek Zyra e Projekteve.

z.Illir Zuka: Edhe një pyetje si shef i prokurimit, jashtë kësaj që e kemi përpara. Unë jam konsultu edhe me ty. Ne e dimë që kanë fillu procedurat për shkëputjen e kontratës për stadiumin e Pozheranit. Ku kanë mbërri, edhe a ka buxhet për rishpallje, për përfundimin e stadiumit.

z.Fadil Abazi: Sipas zhvillimev që janë bërë, është edhe ky viti 2020, edhe pse kontrata ka ngecë për shkak të buxhetit që ministria e premtojke dhe nuk e lëshojke. Tashti ky viti 2022 e ka rëndu operatorin ekonomik, se i kanë lëviz çmimet shumë, dhe ajo tashti ka shprehë interes për shkëputje diku 80 ose 85% kontrata është e realizume, ka mbet një pjesë e vogël, edhe atë pjesë janë tu u mundu me shkëput dhe mandej me ritenderu. Mjetet për sa kam njohuri unë i kan premtu prej ministrisë që, do ta marrim përkrahjen me një grandë edhe për palestrën sportive në Drobesh.

znj.Liridona Bislimi: Kam bërë analizë edhe te prokurimi, dhe më ka interesu tek çerdhja në fshatin Drobesh, domethanë procedurat i ka udhëheq Ministria e Arsimit, ndërsa buxheti është prej nivelit komunal. A është kështu mesa kam mujtë me kuptu unë?

z.Fadil Abazi: Nuk e di, nuk ka qasje që janë zhvillu përmes ministrisë dhe drejtorisë. Te unë unk ka asnjë informatë për këtë punë.

znj.Liridona Bislimi: Nuk e di, e kam diskutu edhe me disa persona të tjerë, edhe nuk është më herët që kemi pas kësaj raste të ngjashme, është rast i veçantë, kështu që mendova mos keni ndonjë sqarim.

z.Fadil Abazi: Nuk kemi as qasje, sepse ata me të drejtë e kanë shpall, e kanë bërë, mirëpo informatat në zyrën tonë janë 0.

znj.Liridona Bislimi: Unë kam parë që kontratat e vitit të kaluar që janë planifiku janë deri në muajin e 8-të, derisa të implementohen, nëse nuk jam gabim, por, tashti ju i keni punu kontratat e reja, keni planifiku kontrata të reja, pse është e nevojshme, kurse egzisotjnë kontratat paraprake edhe janë të paplotsëume edhe për cilat ka ende afatë ligjor me punu me to.

z.Fadil Abazi: Po thu me u përsëritë kontrata e njëjta.

znj.Liridona Bislimi: Po kam parë raste kur ka pas edhe përsëritje të kontratave, por edhe këto të reja që janë bërë nuk po e kuptoj pse me u bë të reja. Këto planifikimet e kontratave të reja që i ke bërë ti, ke pas kontrata të vitit të kaluar të cilat ende nuk janë implementu.

z.Fadil Abazi: Nëse janë 1 vjeçare, atëhere implementohen sivjet. Përsëmbull, nëse është 1 vjeçare deri në muajin e 8-të kryhet kjo, tjetra hyn, fillon, është në veti. Domethanë të dyat të ndamë, nëse është 2 vjeçare e bënë për 1 vjet.

znj.Liridona Bislimi: A nuk mundet me ndiku shembull plotësimin e atyre të vjetrave diçka ngadalësim të proceseve ndoshta, a nuk është mirë me u fokusu në ato që janë paraprakisht.

z.Fadil Abazi: Jo, nëse e ke ti një projekt, e ke të ndamë projektin prej projektit, lokacionet janë të ndara, projekti është që, secili të shkon në punë të vet.

znj.Liridona Bislimi: Tek rendori i prokurive, klasifikimi i produktit te kjo 78-79: pse nuk janë publiku çmimet?

z.Fadil Abazi: Jo çmimet janë kur janë skanu çmimet nuk kanë dalë. Unë mundem me e sjellë edhe origjinalin.

z.Fatlum Demiri, sekretari i kuvendit: Mua kështu më kanë ardhë në e-mail.

z.Fadil Abazi: Nuk ka planifikim pa çmim, ata nuk ta pranojnë, sepse janë shumë striktë.

znj.Liridona Bislimi: Edhe një pyetje e kam te kontrata, që bëhet rregullimi i inkubatorit të biznesit. Ne kemi kontrata të vogla, të mesme, të mëdha. Ka qenë një kontratë e cila është një vlerë prej 521 mijë e 755 euro edhe nuk është e publikume, nuk është e nënshkrume prej kryetarit. Pse ka ndodhë kjo, se normalisht që duhet të bëhet nënshkrimi i tij tek kontrata, rregullimi inkubatorit të biznesit, nuk ka qenë kontrata dhe nuk është e nënshkrume prej kryetarit.

z.Fadil Abazi: Jo nuk ka shancë me ndodhë kjo. Nëse është kanë planifikimi ner 500 mijë, nuk e nënshkrun kryetari, ani pse ka dalë mbi 520 mijë.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: A e bëra një keqkuptim Liridona, por deshta me u përfshi edhe në Drobesh, a e the e udhëheq ministria.

Znj.Liridona Bislimi: Po.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Jo kjo është e parapame tashti, nuk mundet me udhëheq ministria, e ki nr. 89, rregulimi i çerdhes në Drobesh. Ky buxhet është i miratum prej kuvendit tonë, këtë procedurë ne e udhëheqim.

z.Fadil Abazi: Këtë buxhet unë e marr prej financave, prej buxhetit, ata nuk e futin nëse nuk i kemi paret. Udhëheqja e procedurës duhet me memorandum, se ky është grand, e ke fitu, nuk ka rëndësi përqindja, se ne kemi marrë projekte ka 300 mijë euro, ministria ta jepë grandin, në këtë memorandum krijohen kushtet se si të implementohen.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Faleminderit shumë z.Fadil. Kjo pikë nuk votohet, nuk shkon për kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

6. Propozim për ndryshim vendimin për Planin Komunal të Veprimit për Energji dhe Klimë 2022-2030, me Nr.01-110/05-1346, i datës 05.12.2022

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht ne e kemi miratu këtë plan, por që e bisedum edhe më herët është bërë një sygjërim të hjeket emri klimë, të jetë vetëm energji, është plani i njëjtë, vetëm ky përmisim. Nëse nuk ka

për diskutim, atëhere e qesim në votim. Nga të gjithë të pranishmit pro, miratohet kjo pikë e rendit të ditës që të shkoj në kuvend.

Si pikë e shtatë e rendit të ditës:

7. Propozim vendim për ndryshim plotësim Vendimin Nr.01-110/05-111, të datës 01.02.2022, të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Këtu është ndryshimi plotësimi i emrit të drejtorit të arsimit. A jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend. Nga të gjithë të pranishmit pro, kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e tetë e rendit të ditës:

8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026

znj.Ibadete Hyseni përshëndeti të pranishmit dhe para anëtarëve të komitetit bëri prezantimin e propozimit për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Integritetit për Komunën e Vitisë 2023-2026

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Parimisht këtë plan të integritetit e kemi pas edhe më herët, çdo 3 vite që e mirtojmë, besoj që ka përmirësime. Hapi debatë për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për debat, a jeni që kjo pikë të shkojë në kuvend. Nga të gjithë të pranishmit pro, kjo pikë shkon në kuvend.

Si pikë e nëntë e rendit të ditës:

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Gërmovë

z.Ajet Sallahu, drejtori: Përshëndetje të nderuar! Para juve prezantoj propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në fshatin Gërmovë. Është bërë propozim ndarja, me propozim e kam bashkëngjitur matrialin. Për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi, z.Bekim Azizi: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Illir Zuka: Unë kam një pyetje, titulli i propozim vendimit nuk është i mirë ku do që ndërtohet kjo, se kjo ka ardhë njëhere si propozim mu ndertu në Pozheran, edhe jam kanë kategorik mos mu leju. Kisha pas qef që në kuvend le të jetë titulli i saktë për çka ndërtohet kjo, sa për persona me aftësi të kufizuar, të jeni të bindur se është për persona me aftësi të kufizuar (mental) 71-74. Jam konsultu me doktorr e me ministri, ka të bëjë me nivelin më lartë mental, kanë me qëndru aty, duhet me pas kujdes mos me qenë afër shtëpive, rrugëve kryesore. Unë mendoj që duhet me qenë një vend më i mbyll, sepse ku po propozohet ka shpija aty përball është rruga kryesore. Unë kam diskutu edhe me drejtorin në Kamenicë, edhe kemi pas shumë probleme, se ata po i kalojnë rrethojat, kemi pasë probleme që edhe janë mbylltë aty, se ata nuk janë të aftë. Unë kisha kërkua prej drejtoreshës, sepse ajo nuk qenka këtu, saktë titullin për çka është ajo jo me hupë projektin. Ky propozim vendim është propozu me u ndertu në Pozheran, te ambullanta, kategorikisht jam kanë kundërt, edhe mirë që nuk ka ardhë në Pozheran. Nuk jemi kundër asaj kategorie, mirëpo me gjetë një vend adekuat, por besoj që është afër shtëpive edhe aty në Gërmovë edhe rrugë kryesore. Nënkrjetar, tu dashtë me bë mirë po bëjmë dëme. Po mendoj ashtu se, ju apet dini, unë e votova po veç dashta me ndihmu në këtë proces.

Nënkrjetari, z.Hasan Aliu: Ka qenë propozim i drejtoreshës, edhe unë nuk e kam prishë.

z.Illir Zuka: Unë e di që është pronë e komunës, mirëpo duhet me u konsultu edhe me banorët, asnjë problem unë nuk e kam, por ne si Pozheran nuk do ta lejojmë, edhe nuk është ndertu.

Nënkrjetari, z.Hasan Aliu: Unë kam mendu që i bënë nder Pozheranit edhe kam thënë ka me u ndertu kur i kam marrë informacionet.

z.Ramdan Deliu: Nënkrjetar, nëse nuk janë kanë të interesum për asi njerëz me qu në Pozheran, pse në Gërmovë pra po.

Nënkrjetari, z.Hasan Aliu: Kur u njoftu drejtoresha, unë kam qenë atje në ministri së bashku me drejtoreshën edhe këta drejtuesit tek një politikë nacionale që me shpërnda, e çdo komunë me pas, përfituesi saj

ka qenë kamenica 2-3 vite më herët të cilët e ka në funksionalitet, dhe unë kam mendu se ne kemi një shkollë me persona me aftësi të kufizuar “Bafti Haxhiu”, dhe kam mendu se një e tillë do të jetë këtu, se s’kanë dhanë skjarime më detaje, dhe pikërisht për këto ka qenë hulumtimi i parë me bë diku te QKMF që u kanë, mirëpo nuk ka pas hapësirë e kemi kalu në Pozheran, por problem është me u marrë me Ilirin në këtë drejtim dhe nuk është bërë me tendencë ajo, u bë për të mirë të lokalitetit dhe të vendit dhe kur i kemi marrë informacionet që ajo është për personat të cilët e kanë nuk e di nuk jam mjekë 74, 74, 35 dhe prandaj e kemi ndërru qasjen se nuk po deshka me qenë në Pozheran në lokalitet, por dikund tjetër dhe i kemi propozu drejtoreshës me dalë me hulumtu një vend, i cili është më i përshtatshëm, drejtoresha ka ardhë me propozimin për këtë, për shkak se ndoshta i vënë edhe infrastruktura përcjellëse, i vënë rryma, qasja në rrugë, se aty ka me pas edhe punëtorë. Ne nuk mundemi me qu midis malit, se janë shpenzimet shumë më të mëdha. Tash a na ka konvenu me qu në Letnicë atë çështje duhet me programu, se aty duhet të jenë dikun qysh me kanë thanë 6-7 punëtorë të cilët do të punsohen, dhe ti duhesh me ja mundësu edhe qasjen atyre punëtorëve të cilët shkojnë në punë dhe perveç kësaj aty duhet të ketë edhe kuzhin për çdo ditë duhet me qu ushqim. Unë nuk jam për me i pengu vendbanimet, por është kategori të cilët dojnë tretman me i çëmu edhe ata.

z.Ramadan Deliu: Unë për vete e kam qëllimin me qenë plan në rrugët regjionale

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Nuk jam unë decidivisht. Aty ku vendos kuvendi unë jam për me qu, por megjithatë për një objekt të tillë besoj që drejtoresha mandej është kanë më në kontakt pas konfirmimit të asaj që na ka thënë ministritë janë për me vendos. A ka nevojë me pas Vitia një objekt të tillë, unë besoj që kanë krejtë komunat.

znj.Liridona Bislimi: Unë jo rasishtë e pata përmend në kuvend komnal që, një praktikë e tillë e pikave, qoftë në rend të ditës në kuvend, qoftë këtu në komitet, vendosura aty për aty, nuk është një praktikë e mirë, edhe shpeshhere mundemi me vepru edhe jashtë vullnetit tonë, për shkak të situatave që krijohen. Ne patëm kësaj here një numër të madh të pikave të rendit të ditës që i vendosem aty për aty, edhe nuk është që e patëm një material për me lexu edhe me pas materialin, mënyra se si qenka perpilu pikë së pari për mua është e gabume. Ilir, është dashtë paraprakisht para se me dalë në votim me dhanë këtë sqarim, jo pasi e votum për vete. Unë personalisht po mendoj që kjo temë është dashtë shumë më shumë më shtjerrë diskutimin, ndoshta me dalë paraprakisht edhe në diskutim publik, për shkak se vet personat janë shumë më të ndjeshëm, nuk po themë asesi, se nuk i duhet kjo Komunës së Vitisë, i duhet, por lokacioni që qenka vendos për mendimin tem është shumë jo i përshtatshëm. Unë e kam votu për me kalu, tu mendu që është për diçka tjetër, po mendoj që kjo praktikë ndoshta është pak me ndryshu këtë formën e pikave të rendit të ditës, qoftë nëse kishum mujt sot për sot me na dërgu përmes e-mailit zyrtarë, se tashti komunikimi është bërë shumë më i lehtë. Me na ardhë 1 orë përpara me pas kohë me analizu, se mandej po ja shohim sherrin, se vota jonë është shumë e shejtë dhe në bazë të votës sonë mundemi diçka me votu, që ndoshta kalon kohë shumë e gjatë. Një pjesë dërmuese e njerëzve ja shohin sherrin më shumë se hajrin.

z.Ajet Sallahu: Kjo dje është protokolu pikërisht vonesa është bërë për shkak të ndrrimit të lokacionit. Drejtoresha është kanë shumë e angazhume, ja kam dhanë 2 gjeodet dhe deri e ka gjetë pronën edhe na u ka dokë shumë për me shku në seancën tjetër, se këtu i murrë nënkryetari të gjitha, se tha ky unë jam fajtorë, por nuk është për të gjitha, se ne jemi vonu deri sa e kemi gjetë lokacionin, se është shumë problem. Drejtoresha e ka vlerësu që nuk është e dëmshme, janë shiqu shumë lokacione tjera, prandaj unë kisha lutë që kjo me shku në kuvendë me u shqyrtu në kuvend dhe aty me dhanë sqarime edhe drejtoresha dhe aty keni me pas më të qartë situatën.

z.Ramadan Deliu: Drejtoresha e ke vlerësu që është në rregull a?

z.Ajet Sallahu: Po sikur ju që jeni edhe ajo është, ajo ka dalë në teren e ka vlerësu sa është larg.

z.Ilir Zuka: Pse drejtor po thua si ju?

z.Ajet Sallahu: Si ju që po e vlerësoni tashti edhe ju nuk jeni eksperta për këtë punë.

z.Ilir Zuka: Në momentin që e kam votu me hy si pikë e rendit të ditës unë do ta votoj të hy në kuvend, po lusë nga drejtoresha pikë së pari titullin, emërimin, domethanë propozim vendimin ne ta shkrum si duhet, se është gabim i shkrum, se më tha nënkryetari nuk kam asgjë. Me nënkryetarin po kthehem prapë, unë kam pas

takim në Ministrinë e Financave direkt me Këshill të Pozheranit kemi shku dhe kemi marrë saktë informatën, pasi ne i kemi thirrë në telefon edhe drejtorin e Kamenicës, propozimi si është i shkrum tha është gabim edhe ne ta spjegonë edhe është kanë mirë me pas një takim me ata qytetarë, se është problem për ata shpijat që janë afër nuk jam kundër, sepse nesër secili mundemi me pas nga një në familje, është shumë rastë i ndjeshëm nuk jam kundër unë, por kur të vjen drejtoresha në ta përmirëson propozim vendimin, ta shkrun saktë dhe një arsyshmeri se si është.

Kryesuesi z.Bekim Azizi: Ilir, unë mendoj që titulli është mirë, po ne duhet me kërku informacione shtesë, me pa më detale se çka.

z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës: Ne kemi qenë në takim, edhe drejtoresha ka qenë, na ka pritë, ka tregu, është një program ka thënë për persona me aftësi të kufizuara. Unë kam qenë, hiq nuk e ka tregu atë se unë me i shtremu fatket nuk mundem, dhe unë e kam marrë shumë mirë, i kam pyet se sa është numri i punëtorëve, mua më intereson ata punëtorë a kanë me na e shti në sistem, po është program i joni, një çështje të tillë e kemi marrë gabim, informacionin e kam marrë prej teje dhe prej Naimit, dhe i kam thirrë unë, në Kamenicë nënkryetarin e komunës e kam thirrë, mandej atë kategori e kam thirrë edhe drejtoreshën. Drejtoresha tashti ish kanë në rrjedha dhe tha, po nënkryetarë, në Pozheran nuk mundet me u vendos në QKMF, por duhet të vendoset në një lokacion që nuk e pengon askënd dhe nuk bënë me hupë këtë donacion.

z.Ilir Zuka: Kur kam diskutu me drejtorin para se me i informu Naimin në mënyrë zyrtare, unë jam administratori i Pozheranit, kemi fol që është mirë për këtë kategori me u ndërtu, kemi fol vetëm 5 minuta, thashë e kam një pyetje si qytetar i Pozheranit, jo zyrtarishtë 1% në paqi mundësi mos e lejoni me e ndërtu se kanë me ja pa sherrin ata familjarë që janë afër dhe ata njerëz. Unë nuk jam kundër për ndërtim, por jam kundër lokacionit.

Kryesuesi z.Bekim Azizi; Faleminderit! A jeni që kjo pikë të shkoj në kuvend? 3 vota janë për, kundër nuk ka, apstenim 1, kjo pikë kalonë për në kuvend.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:00

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Bekim Azizi



Pranuar - Primeno Mirëdita 16-03-2023			
Nr./ organit	Numri/Broj	Shtetëso	Vlera
Org.broj		Prilog	Vrednost
02-035/02-219			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare nr 28/2008), dhe nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.201, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë

PROPOZIM VENDIM

Për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve), në Komunën e Vitisë me fshatra

Neni 1

Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë të formon komisionin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve), në Komunën e Vitisë me fshatra. Komisioni ka këtë përbërje:

- | | |
|---------------------|--|
| 1. _____ | Nga subjekti politik LDK, anëtar |
| 2. _____ | Nga subjekti politik VV, anëtar |
| 3. _____ | Nga subjekti politik PDK, anëtar |
| 4. Feat Shaqiri | Gjeodet, anëtar |
| 5. _____ | Historian, anëtar |
| 6. _____ | Gjeograf, anëtar |
| 7. _____ | Veteran i lutës, anëtar |
| 8. Perparim Sadiku | Gjuhëtar, anëtar |
| 9. _____ | Sociolog, anëtar |
| 10. Qëndrim Kajolli | Koordinatori i këshillave të fshatrave, anëtar |
| 11. _____ | shoqëria civile, anëtar |
| 12. Sadat Sejdiu | Drejtorja e Urbanizmit |

Neni 2

Anëtarët e Komisionit nga neni 1 të këtij propozim vendimi zgjedhën me mandat- kohëzgjatje si të anëtarëve të Kuvendit Komunal.

Neni 3

Komisioni në mbledhjen e pare do ta zgjedhe kryesuesin dhe zëvendës kryesuesin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve), në Komunën e Vitisë me fshatra.

Neni 4

Detyrat e komisionit nga neni 1 e këtij propozim vendimi janë: shqyrtimi i kërkesave, ankesave, për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike në Komunën e Vitisë me fshatra, dhe përgatitja e propozimeve bazuar në kriteret përkatëse të përcaktuara me ligjet apo aktet nënligjore në fuqi,

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe anëtarët e këtij komisioni.

Neni 6

Me hyrjen në fuqi të këtij propozim vendimi shfuqizohet vendimi me Nr.01-110/05-262, i datës 10.06.2019, mbi formimin e komisioni për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, vendeve tjera publike (shesheve) në Komunën e Vitisë me fshatra

Neni 7

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.
Propozues: Kryetari i Komunës, S. HALLI





KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prirëno Mbi Dana			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vredn. sh.
02-036/02-218			

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOŠOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.28/2008), neni 50 paragrafi 1 shkronja I, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011 dhe kërkesa e Drejtorisë së Shendetësis dhe Mirqenjes Sociale në komunën e Vitisë me nr.04-320/02-1365, e datës 06.12.2022, Kryetari i Komunës me datën 14.03.2023 bën këtë :

PROPOZIM VENDIM
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDERTIMIN E OBJEKTIT PËR PËRSONAT ME AFTËSI TË
KUFIZUAR NË FSHATIN BINÇË

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të caktohet lokacioni për ndertimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në zonën kadastrale në Binçë.

Neni 2.

Lokacionin për ndertimin e objektit për personat me aftësi të kufizuar në zonën kadastrale në Binçë, caktohet në parcelën kadastrale me nr. P-70101003-01807-0, vendi i quajtur „ Golema Reka Centrala“, me sipërfaqe prej 3003m², në zonën kadastrale në Binçë, Komuna e Vitisë që evidentohet në pronësi të pronarës Komuna e Vitisë në Viti.

Neni 3.

Ndertimi i objektit për personat me aftësi të kufizuar në zonën kadastrale në Binçë do të financohet nga Ministria e Financave , Punës dhe Transfereve, me qellim të krijimit të kushteve më të mira për personat me aftësi të kufizuar.

Neni 4.

Pjesë përbërse të këtij propozim –vendimi është : fleta poseduese , kopja planit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria e Shendetësis dhe Mirqenjes Sociale dhe Drejtoria për Kadaster , Pronë dhe Gjeodezi e komunës së Vitisë.

Neni 6.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Soli





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : VITI

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Binçë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70101003-01807-0	Parcelë / Parcela / Parcel	3003



Shkalla/Razmera/Scale: 1:605

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 14.03.2023


Koha/ Vreme/ Time: 09:31:50

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoj/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:





Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101003-01807-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 569/2023
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 14.03.2023 - 09:27
Komuna / Opština / Municipality: VITI / VITINA / VITI
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastrol Zone: Binçë / Binac / Binçe
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastrol Office: VITI / VITINA / VITI

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R C/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrimi Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101003-01807-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		3003			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postali Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GOLEMA REKA CENTRALA				

..2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numeri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujësi/Poljoprivreda/Agriculture	Kullosa/Pashnjac/pasture	Kullose I: Klasës 4/Pashnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	2368
2	Tokë Ndërtimore/Građevinska zemljište/Construction land	Oborr/Dvoršte/Back Yard		500
3	Tokë Ndërtimore/Građevinsko zemljište/Construction land	Shëqep: Ndërtimor/Kuca- Zgrada/House-Building		135

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personat Licent broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postat Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostoi adrese Address details	Pjesa e prouës Dee imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Poseëdm individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Vitisë	600424486	///		28 NENTORI	1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primenë Miratuar			
16.03.2017			
Nr./ organit Org broj	Numri/Broj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednost
02-035/02-220			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58 pika h Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, nenit 50 shkronja I të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshim-plotësimin të vendimit nr.01-013/372, të datës 04.04.2017, për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj

Neni I

Kryetari i Komunës së Vitisë i PROPOZON, Kuvendit të Komunës së Vitisë që ta ndryshon-plotësoj vendimin me Nr. 01-013/372, të datës 04.04.2017, për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj.

Neni II

Rrugët e cekura në nenin 2 të vendimit bazë rrugët si më poshtë, fshihen dhe të njëjta shëdërrohen në rrugë dy kahje si:

- Rruga "Xhemajl Ademi",
- Rruga "Safet Rexhepi", duke filluar nga rruga Xhemajl Ademi e deri te Rruga "Kongresi i Manastirit", si dhe
- Rruga "Kongresi i Manastirit" duke filluar nga rruga "Safet Rexhepi" deri tek rruga "2 Korriku".

Neni III

Në nenin 5 të vendimi bazik, teksti pas paragrafit 5.5 të nenit 5, fshihet terisht nga vendimi baze sepse ka ndryshuar gjendja faktike.

Neni IV

Pjesët tjera të vendimit baze mbasin të pa ndryshuara.

Neni V

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë


KRYETARI I KOMUNES

Sokol Haxhi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d), neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008) nenit 36, paragrafi 36.2 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 29.03.2017 merr këtë:

VENDIM

Për rregullimin e komunikacionit në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë rregullon qarkullimi normal të mjeteve të trafikut, drejtimet e lëvizjes së mjeteve të trafikut, vendet për parkimin e mjeteve të trafikut, vendndaljet e mjeteve të transportit publik, vendosjen e shenjave të komunikacionit, vendkalimet për këmbësorë, rregullimin e trotuareve si dhe lëvizja e këmbësorëve.

Neni 2

Komunikacioni në qytetin e Vitisë dhe territorin e saj zhvillohet në dy drejtime pos në këto rrugë ku komunikacioni zhvillohet në një drejtim, e që janë:

Në qytetin e Vitisë :

-Rruga "Adem Jashari"

-Rruga "Xhemajl Ademi"

-Rruga "Agim Ramadani"

- Rruga e "UÇK-së", një pjesë e segmentit të kësaj rruge (duke filluar nga rruga "28 Nëntori" e deri te rruga "11 Marsi"

-Rruga "Safet Rexhepi", duke filluar nga rruga "Xhemajl Ademi" e deri te rruga "Kongresi i Manastirit"

-Rruga "28 Nëntori"

-Rruga "Mustafë Koka" një segment i sajë nga rruga "Agim Ramadani" deri te Rruga "Njazi Rexhepi" (ish rruga e Shkupit)

-Rruga "Kongresi i Manastirit" duke filluar nga rruga "Safet Rexhepi" deri te rruga "2 Korriku"

2.1. Ndërsa në fshatin Pozheran, Rruga "Sylejman Aga", zhvillohet qarkullimi në një kahje, një segment i kësaj rruge nga Rruga Pozheran - Sllatinë e deri te Xhamia e re e fshatit.

Neni 3

Të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë dhe vendbanimeve tjera duhet të pajisen me shenja përkatëse të Komunikacionit.

Neni 4

VENDEKALIMET PËR KËMBËSOR

4.1. Në të gjitha rrugët e qytetit të Vitisë duhet të ketë vendkalime për këmbësor, por duke pasur parasysh se shumica e këtyre rrugëve janë të ndërtuara edhe me trotuare, për të pasur një qarkullim më të lirë edhe të automjeteve, kemi paraparë që vendkalimet të ndërtohen kryesisht në vendet e rëndësisë së veçantë si në afërsi të Institucioneve, Shkollave, Ambulancave, Çerdheve, Pushimoreve, Parqeve, Policisë, Gjykatës etj.

4.2. Me këtë rast kemi specifikuar secilën rrugë veç e veç, dhe atë:

- **Rruga “Rexhep Bislimi”** 3 vendkalime:
 - përball Shtëpisë së Shëndetit,
 - përball “Viva-Fresh” (Shkolla Filllore),
 - afër stacionit të Autobusëve.
- **Rruga “Hoxhë Jonuzi”**, afër Xhamisë të rrethrotullimi, 4 vendkalime të pasqyra 3 vendkalime për këmbësorë.
- **Rruga “2 Korriku”**– 1 (një) vendkalim afër udhëkryqit me rrugën “HasanPrishtina” dhe 1 (një) të udhëkryqi me rrugët “DautZenuni” dhe “Sherif Frangu”
- **Rruga “Adem Jashari”** 1 (një) vendkalim përball ndërtesës së Policisë dhe DKA-së, 1 (një) vendkalim përball IPKO-s4 vendkalime të udhëkryqi afër Komunës dhe 1 (një) afër qebaptores “Jeta” dhe parkut të qytetit.
- **Rruga “Brigada 173”** 1 (një) përballë NLB-së dhe Lindit, 2 vendkalime të udhëkryqi me rrugën “11 Marsi” dhe 1 (një) përball “SebaMarket” dhe “Rida” 4 në rrethrotullimin e (ashtuquajtur i Kabashit) të ndërtesa e verdhë.
- **Rruga “Lidhja e Prizerenit”** 2 vendkalime një në hyrje dhe një në dalje të rrugës.
- **Rruga “Agim Ramadani”** 4 vendkalime një afër shkollës fillore “M. Markoviç”, nga një afër Urave kaluese mbi lumin “Morava” dhe një përball “Pres Com-it”.
- **Rruga e “UÇK-së”** 2 vendkalime një përball rrugës “28 Nëntori” dhe 1 përball rrugës “11 Marsi”.
- **Rruga “11 Marsi”** 1 vendkalim afër udhëkryqit me rrugën “Brigada 173” dhe 1 (një) përballë librisë “KOHA”
- **Rruga “Kemajl Azizi”** 1 vendkalim afër oborrit të Shkollave të Mesme, dhe 1 (një) të rrugës e Beguncës.
- **Rruga “Kongresi i Manastirit”** një vendkalim në fillim dhe një në përfundim të rrugës.
- **Rruga “Iliria”** një vendkalim përballë Shkollës Filllore “Bafti Haxhiu”.
- **Rruga “Mustafë Koka”** një vendkalim përballë rrugës private dhe një afër servisit të IzerIsakut.
- **Rruga “Nënë Tereza”** një vendkalim përballë rrugës së Beguncës.

Neni 5

TROTUARET PËR KËMBËSOR

5.1. Trotuaret janë sipërfaqe publike të cilat shfrytëzohen për ecjen e këmbësorëve.

5.2. Në sipërfaqet e trotuareve dhe të shesheve të vogla nuk lejohet shitja dhe vendosja e gjësendeve për zhvillimin e ndonjë veprimtarie.

5.3. Trotuaret dhe sheshet e vogla mundë të shfrytëzohen për shkarkimin e mallit dhe të materialeve të tjera si p.sh. për ngrohje etj. Vetëm me lejen paraprake të organit të administratës.

5.4. Vendosja në hapësira publike e objekteve të përkohshme nuk mundë të bëhet pa u pajisur me leje të veçantë nga DSHPE-ja.

5.5. Ndalohet hedhja e dheut, rërës, gurëve dhe materialit tjetër nëpër trotuare, sheshe të vogla rrugë dhe sipërfaqe tjera të lira publike.

Për fatin e mirë të qytetarëve të Vitisë, shumica e rrugëve janë të ndërtuara edhe me trotuar për lëvizje të lirë të këmbësorëve, me përjashtim të Rrugës "Safet Rexhepi", "Agim Ramadani", "Mustafë Koka", "Elena Gjika" dhe disa segmente të pa përfunduara si Rruga "Brigada 173", "11 Marsi", "28 Nëntori", "UÇK-s" etj.

Neni 6

VENDPARKIMET

Qyteti i Vitisë do të ketë disa vend parkime për automjete të udhëtarëve dhe 1 vend parkim për automjete të transportit të mallrave.

Disa nga vend parkimet janë të sektorit publik e disa të atij privat, ku i kemi të ndarë në ato me pagesë dhe pa pagesë.

6.1. Gjithashtu kemi edhe vend parkime të institucioneve përkatëse:

- Vend-parkimet publike me pagesë janë në rrugën "Adem Jashari" dhe "Xhemajl Ademi".
- Vend-parkimet pa pagesë janë në Rrugën "Kongresi i Manastirit", rrugën "Rexhep Bislimi", rrugën "Brigada 173", te varrezat e Dëshmorëve, etj.

Vend-parkimet e institucioneve janë:

1. QKMF "Nënë Tereza" (Ambulanta),
2. Qendra për Punë Sociale,
3. Kryesia e Bashkësisë Islame (te Xhamia),
4. Gjykata Themelore në Gjilan dega në Viti,
5. Policia e Kosovës (Stacioni Policor Viti),
6. Autoparku i Komunës së Vitisë,
7. Qendrat Shkollore etj.

Vend-parkimet private gjenden:

1. Në rrugën "Hoxhë Jonuzi" një vend-parkim
2. Në rrugën "28 Nëntori" dy vendparkime
3. Në rrugën "Adem Jashari" një vend-parkim etj.

6.2. Vend-parkim për automjete të Transportit të mallrave

Edhe pse me planin e mobilitetit ky vend parkim ka qenë i paraparë në Rrugën "Shote dhe Azem Galica", tani kjo pjesë është destinuar për ndërtime të tjera, andaj për momentin kemi zgjedhur rrugën "Selami e Mehmet Ismajli" afër Stacionit të Zjarrfikësve.

6.3. Vend-parkimet për Auto-Taxi

Duke pasur parasysh numrin mjaftë të madh të Autotaksive (mbi 100), kemi bërë shpërndarjen e tyre nëpër disa pika më frekuentuese të qytetit të Vitisë, dhe atë:

1. Një vend-parkim në rrugën "Rexhep Bislimi" para sektorit të pyjeve.
2. Një vend-parkim në rrugën "Shote dhe AzemGalica" nga të dy anët e kësaj rruge.
3. Një vend-parkim në rrugën "Hoxhë Jonuzi" (te rrethi përballë Xhamisë).
4. Një vend-parkim në rrugën "Adem Jashari" (te pasqyrja).
5. Një vend-parkim në rrugën "Kongresi i Manastirit" (përkaj prockes afër "2Korrikut).
6. Një vend-parkim në rrugën "Adem Jashari " në qendër të qytetit.
7. Një vend-parkim në rrugën "IdrizSeferi" (përkaj lumit "Morava" afër Urës).
8. Sipas planifikimit të Kryetarit nga zyra e projekteve,do të ketë edhe një vendparkim për Taxi në rrugën "KemajlAzizi" bri (oborrit të Shkollës së mesme Teknike).

6.4.Vend-ndaljet për Autobus

Stacioni i autobusëve në Viti gjendet në rrugën " Rexhep Bislimi" (bri lumit Morava).

Vend-ndaljet për autobus në qytetin e Vitisë , përpos Stacionit të Autobusëve ;

1. Në Rr."RexhepBislimi" në hyrje të Vitisë nga Klllokoti përballë QKMF-s
2. Në dalje të Vitisë Rr."RexhepBislimi" përballë OP "VINEX"
3. Në Rr."2 Korriku" (te pasqyrja) nga të dy kahet.
4. Në Rr."KemajlAzizi" (afër Shkollave të Mesme) nga të dy kahet.

Në fshatin **Lubishtë 2(dy)** vend-ndalje: një në qendër të fshatit dhe një në rrugën kryesore afër shtëpisë së Nuhinura (kroni publik) një afër Mustafoviqe, një afër Lagjes së Shukriovite.

Në fshatin**Letnicë** në qendër të fshatit

Në fshatin **Stubëll e Epërmepërballë** Restaurant "Jozefi"

Në fshatin **Gjylekarë** një vend-ndalje në qendër të fshatit afër Ambulantës, dhe një afër përmendores së Dëshmorit "Hoxhë Jonuzi"

Në fshatin **Remnik** një vend-ndalje në qendër të fshatit te Xhamia dhe një përballë shtëpisë së mësuesit Isa Hajdari

Në fshatin **Budrikë e Epërme** një vend-ndalje në qendër të fshatit afër Xhamisë dhe një te Qeshmja.

Në fshatin **Devajë** një vendndalje në qendër të fshatit

Në fshatin **Zhiti** një vend-ndalje te rruga e Ballancës (shitorja e Hajrushit)

Në fshatin **Ballancë** një vend-ndalje te shitorja "LONI" dhe një te Shkolla efshatit

Në fshatin **Tërpezë** një vend-ndalje te shtëpia e MejdiHalimit dhe një te Shkolla

Në fshatin **Sllatinë e Poshtme** një Vend-ndalje te Shkolla dhe një te Kroni

Në fshatin **Sllatinë e Epërme** një vend-ndalje te shitorja e Abazve një te qendra (pompa e benzinës) një te Lisi (Gjinollt) ,dhe te Rr.eTrestenikut

Në fshatin **Trestenik** një vend-ndalje te Xhamia dhe një te Lisi i Gjellbët

Në fshatin **Sodovinë e Qerkezve** një te Turjant dhe një te shitorja e Rifatit

Në fshatin **Vërban** një vend-ndalje te Xhamia dhe një te Vorrezat

Në fshatin**Goshicë** një vend-ndalje te Xhamia një te lagja e Livoqve një te shtëpia e Ejupit (muhaxhert)

Në **Smirë** një vend-ndalje te Stubet një te Vorrezat, dhe një në qendër të fshatit

Në **Drobesh** një vend-ndalje te shitorja e Ramizit dhe një te shit.e Përparimit.

6.5.Komuna përkatësisht zyra e projekteve duhet që të hartoj projektet për rregullimin e këtyre Vend-ndaljeve me qëllim të rritjes së sigurisë në Komunikacion

Neni 7

Mjetet për zbatimin e këtij vendimi do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2017-2022.

Neni 8

Dispozitat ndëshkuese

8.1.Ndalohet qarkullimi apo lëvizja e automjeteve dhe mjeteve të tjera në kundërshtim me parimet e këtij Vendimi, dhe Ligjeve të tjera në fuqi.Personat që bëjnë shkelje e që është e ndaluar me këtë Vendim sipas Nenit 5 pikat 2,3,4 dhe 5,do të ndëshkohen me dënim (gjobë) nga 40 € deri në 150 € për personat fizik dhe prej 200 € deri në 500 € për personat Juridik.

8.2.Ndalohet zënia e rrugëve dhe trotuareve me qëllim të shfrytëzimit të bizneseve apo personave të tjerë pa lejen e organit kompetentë Komunal.Personat që bëjnë këto shkelje do të ndëshkohen me dënime (gjoba) mandatore nga 50€ deri në 100 € personat fizik dhe nga 150€ deri në 300€ personat juridik.

8.3.Ndalohet shfrytëzimi i hapësirave publike me qëllime biznesi apo marketingu me përjashtim të atyre me leje përkatëse, e cila leje nuk guxon të jepet për shfrytëzimin e trotuarit për kalimin e këmbësorëve në gjerësi deri në 1.5 m.Personat e tillë që bëjnë këtë shkelje (kundërvajtje), do të ndëshkohen me dënim nga 50€ deri në 100 €, personat fizik dhe me nga 150€ deri në 300 € personat juridik.

8.4.Ndalohet marrja dhe zbritja e udhëtarëve në transportin publik jashtë vendeve të caktuar për këtë qëllim, dmth. jashtë vendndaljes për Autobus.Shoferët që bëjnë këtë shkelje do të dënohen me gjobë prej 50€ deri në 100€, ndërsa kompania e transportit do të ndëshkohet nga 200€ deri në 300 €.

8.5.Ndalohet marrja dhe zbritja e udhëtarëve (pasagjerëve) me Auto-taksi, në vendet ku ashtë e ndaluar ndalja dhe parkimi për automjete. Shoferët e këtyre taksive do të dënohen me gjobë nga 30€ deri në 50 €.

8.6.Ndalohet lënia e gjësendeve në rrugë si material ndërtimor, orendi të ndryshme etj. Të cilat pengojnë qarkullimin e lirë të pjesëmarrësve në Komunikacion.Personat fizik që bëjnë këtë shkelje do të dënohen me gjobë nga 50 € deri në 150 €, ndërsa personat juridik do të dënohen me gjobë nga 200€ deri në 300 €.

Neni 9

Mbikqyrja

Për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtijvendimi do të përkujdesen organet Komunale të Administratës si: DSHP-ja, Sektori për Trafik dhe Transport, Drejtoria përUrbanizëm, Drejtoria për Inspeksion dhe Policia e Kosovës (PK-ja) (Stacioni Policor në Viti).

Neni 10

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për rregullimin e Komunikacionit me Nr.01-013/2886 i datës: 13.06.2008, dhe Vendimi me Nr.10-013/248 të datës 10.04.2002.

10.1. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në kuptim të nenit 81, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 të Rregullores Nr.01/2016, për shqyrtimin administrative të akteve të Komunave dhe pas publikimit në Web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Shërbimit të Kuvendit,
2. Drejtoria e Inspeksionit,
3. Policia e Kosovës (Stacioni Policor në Viti), dhe
3. Arkivit

KRYESUESI

Naim Pira





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA			
Pranuar - E miratuar më datën: 17-03-2023			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Eroj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednost
02-035/02-234			

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË / OPSTINA VITINA / MUNICIPALITY OF VITIA



Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr.28/2008 dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1, të Ligjit me nr. 06/L-092, Për Dhënjën në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Palujtshme të Komunës dhe neni 50 paragrafi 1 shkronja I, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë me datën 16.03.2023, bën këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit paraprak me nr. 01-110/05-657 të datës 30.06.2022 për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

Neni 1

Me këtë propozim – vendim propozohet të behet ndryshimin dhe plotësimin i vendimit paraprak 01-110/05-657 të datës 30.06.2022, për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.

Neni 2.

Sipas vendimit të cekur në piken I, plotësim – ndryshimi nënkupton:

Neni 3.

Propozohet të ndryshohet neni 2 i Vendimit, ndryshohet afati i dhënjes në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale nga afatshkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve ndryshohet dhe plotësohet në dhënjën në shfrytëzim të pronës së palujtshme komunale afatgjatë. Pjesët tjera të vendimit mbeten të pandryshuar.

Neni 4.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Kryetari i Komunës
Sokol Haxhiu





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Vitia

30-06-2022

01-110/05-657

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, neni 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), dhe neni 6 paragrafi 1, pika 1.1, neni 8 paragrafi 1 pika 1.1 lidhur me neni 14, të Ligjit me Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.06.2022, merr këtë:

V E N D I M

paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik, si në vijim:

1. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00211-2, vendi i quajtur „Visoça“ me sipërfaqe prej 81412 m²;
2. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00211-4, vendi i quajtur „Visoça“ me sipërfaqe prej 206276 m²;
3. Njësia kadastrale me nr. P-70101018-00098-0, vendi i quajtur „Golesh“ me sipërfaqe prej 771703 m², në zonën kadastrale në Devajë, komuna e Vitisë.

Neni 2

Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është afat shkurtër me kohëzgjatje prej 15 viteve, me kultivimin e kulturave bujqësore, me qëllim të shfrytëzimit nga ana e personave fizik apo juridik. Caktimi i afatit kohorë për ndertimin e duhet të jetë: brenda një viti duhet të filloj projekti pasi të shpallet fituesi.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës komunale është interesi publik dhe përfitimi ekonomik i komunës nga prona komunale.

Neni 4

Procedurat për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër realizohet përmes ankandit publik, në harmoni me Ligjin Nr.06/L092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Neni 5

Mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të kryetarit të Komunës dhe përfituesi i marrjes në shfrytëzim të pronës së paluajtshme në periudhë afatshkurtër të shfrytëzimit, me të drejtë të shkëputjes së kontratës edhe para afatit, nëse prona e dhënë në shfrytëzim nuk shfrytëzohet për qëllime të cekura në nenin 2 të këtij vendimi.

Neni 6

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës, Drejtoria për Administratë, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjent dhe Drejtoria për Financa e Komunës së Vitisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Prilazhe Mirjana 17-03-2023			
Nr./ organizat	Numri/Broj	Shtetësi	Vlera
Org. broj		Prilog	Vrednost
01-035/02-229			



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 28/2008, Udhezimin Administrativ MAPL-05/2020, për procedurën e themelimit, përbërjen e kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë, nenit 47 shkronja g të Statutit të Komunës së Vitisë nr.01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë, paraqet këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndryshim plotësim të vendimit nr.01-110/05-395, të datës 08.04.2022, për formimin e Komitetit për Shërbime Publike

Neni 1.

Me këtë propozim vendim, Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë që të bënë ndryshim plotësimin e vendimit nr.01-110/05-395, të datës 08.04.2022, për formimin e Komitetit për Shërbime Publike.

Neni 2.

Konform nenit 1 të këtij propozim vendimi, Komitetit për Shërbime Publike duhet të ndryshohet dhe të plotësohet, ku nenin 2 i vendimit nr.01-110/05-395, të datës 08.04.2022 anëtarin me numër rendor 2. znj. Taibe Ibrahim zëvendësohet me znj. Marigona Avdiu.

Neni 3.

Te gjitha pjesë tjera të vendimi nr.01-110/05-395, të datës 08.04.2022, formimin e Komitetit për Shërbime Publike mbetet të pandryshuara.

Neni 4.

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë

KRYESUESI
Bekim Azizi

